



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2018 – Numri: 33

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E hënë, 12 mars 2018

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 10737, datë 7.3.2018	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 2211
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 124, datë 7.3.2018	Për emërimin në detyrë të disa anëtarëve të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile..... 2211
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 7.3.2018	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1037, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e vlerësimit të nëpunësve civilë për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë”..... 2211
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 126, datë 7.3.2018	Për disa ndryshime në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për pjesëmarrjen e një toge të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të NATO-s në Letoni”..... 2214
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 137, datë 28.2.2018	Për ngritjen e Task-Forcës për evidentimin e pasurive të paluajtshme shtetërore gjatë bregdetit shqiptar, me qëllim investimin në turizmin bregdetar..... 2215

**DEKRET****Nr. 10737, datë 7.3.2018****PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Mustafa Rahman Muçaj
2. Leart Mustafa Muçaj

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

**PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

VENDIM**Nr. 124, datë 7.3.2018****PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DISA
ANËTARËVE TË BORDIT MBIKËQYRËS
TË AGJENCISË PËR MBËSHTETJEN
E SHOQËRISË CIVILE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8 e 13, të ligjit nr. 10093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Emërimin në detyrë të disa anëtarëve të bordit mbikëqyrës të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, përfaqësues nga organizatat e shoqërisë civile, si më poshtë vijon:

- Z. Adrian Thano;
- Z. Alban Dudushi;
- Z. Aldo Merkoçi;
- Z. Ismail Ademi;
- Znj. Kozara Kati.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 12.3.2018.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 125, datë 7.3.2018****PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA
NË VENDIMIN NR. 1037, DATË 16.12.2015,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PROCEDURAT E VLERËSIMIT
TË NËPUNËSVE CIVILË
PËR PËRFITIMIN DHE PËRDITËSIMIN
E NJOHURIVE SHITESË”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1/1, të nenit 62, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 1037, datë 16.12.2015, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

2. Në pikën 2, të kreut I, fjalët “... dhe intervistimi i tyre me gojë ...” hiqen.

Kreu II ndryshohet, si më poshtë vijon:

“KREU II**PLANIFIKIMI DHE GRUPIMI I
NËPUNËSVE CIVILË**

1. Çdo nëpunës civil është i detyruar t'i nënshtrohet, periodikisht, testimi paraprak dhe, kur është e nevojshme, procedurës së trajnimit çdo 4 vjet. Kur nuk është e mundur, ky vlerësim mund të shtyhet deri në 6 vjet. Përgjatimisht, nëpunësit civilë në njësitë teknike të përmbajtjes së sistemeve tatimore e doganore janë të detyruar t'i nënshtrohen kësaj procedure çdo 2 vjet.

2. Nuk i nënshtrohen kësaj procedure:

a) nëpunësit civilë të kategorisë së lartë drejtuese;

b) nëpunësit civilë në periudhë prove;

c) nëpunësit civilë, të cilët janë të pezulluar;

ç) nëpunësit civilë, të cilët janë me leje lindjeje;

d) nëpunësit civilë, të cilët kanë kryer procedurën e lëvizjes paralele apo atë të ngritjes në detyrë në vitin e fundit, përpara zhvillimit të procedurës;

dh) nëpunësit civilë në vitin e fundit të punës, përpara mbushjes së moshës së pensionit;

e) diplomatët e karrierës.

3. Nëpunësit civilë sipas shkronjave “c”, “ç” e “d”, të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, i



nënshtrohen kësaj procedure, përkatësisht, 1 vit pas sistemit të tyre në një pozicion pune, 1 vit pas përfundimit të lejes së lindjes apo 1 vit pas emërimit, si pasojë e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë.

4. Mosparaqitja e nëpunësve civilë në testimin paraprak apo testimin në përfundim të trajnimit, pa shkaqe të arsyeshme, konsiderohet shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin e nëpunësit civil dhe përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore.

5. Në kuptim të pikës 4, të kreut II, të këtij vendimi, shkaqe të arsyeshme konsiderohen:

- rastet e sëmundjeve të nëpunësit civil apo fëmijëve të mitur, vërtetuar me raport mjekësor;
- martesa e nëpunësit civil;
- martesa e fëmijës së tij;
- vdekja e prindërve, gjyshërve, bashkëshortit/es, fëmijës, vëllezërve, motrave;
- sëmundjet e rënda të fëmijëve, prindërve, bashkëshortit/es, të vërtetuara me raport mjekësor;
- rastet e trajnimit jashtë vendit të nëpunësve civilë, për një periudhë me të gjatë se 1 muaj, të organizuar nga institucioni.

6. Nëpunësit civilë, të cilët nuk paraqiten në testimin paraprak apo në testimin në përfundim të trajnimit për shkaqet e arsyeshme të përcaktuara sipas pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, janë të detyruar t'i nënshtrohen procedurës së testimit, si më poshtë vijon:

- Në rastet e testimit paraprak, brenda 3 muajve, nga data e rikthimit në punë;
- Në rastet e testimit në përfundim të trajnimit, brenda 1 muaji, nga data e rikthimit në punë.

7. Grupet e pozicioneve dhe fushat e njohurive, për të cilat do të zhvillohet procesi i vlerësimit për përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, përcaktohen brenda muajit shkurt të çdo viti, nga:

a) Departamenti i Administratës Publike, në bashkëpunim me njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve, për institucionet e administratës shtetërore;

b) njësitë përgjegjëse të institucioneve të pavarura, për secilin institucion të pavarur.

8. Brenda muajit mars të çdo viti, ASPA, në bashkëpunim dhe bazuar në rekomandimet e DAP-it, për institucionet e administratës shtetërore dhe të njësive përgjegjëse të institucioneve të pavarura, harton programet e trajnimit për fushat e përcaktuara, sipas pikës 7, të kreut II, të këtij vendimi, për këto institucione. Programet dhe

mënyra e zhvillimit të tyre miratohen nga bordi i ASPA-s dhe duhet të zgjasin 10 deri në 20 ditë.

9. Departamenti i Administratës Publike dhe njësitë përgjegjëse të institucioneve të pavarura, brenda muajit mars të çdo viti, publikojnë në faqet e tyre zyrtare dhe, për njësitë e vetëqeverisjes vendore ose/edhe në stendat e informimit të publikut, kalendarin vjetor të testeve paraprake për secilin nga grupet e përcaktuara sipas pikës 7, të kreut II, të këtij vendimi.

10. Brenda muajit prill të çdo viti, DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore dhe njësitë përgjegjëse, për institucionet e pavarura, hartojnë listat e nëpunësve, të cilët do t'i nënshtrohen kësaj procedure dhe, bazuar në dosjet e nëpunësve e në përshkrimet e tyre të punës, bëjnë ndarjen e tyre në grupe të përbashkëta. Në këto grupe marrin pjesë nëpunësit që kanë përshkrime pune të njëjta/të përafërta.

11. Grupet me listat e nëpunësve, të përcaktuar sipas pikës 10, të kreut II, të këtij vendimi, për institucionet e administratës shtetërore, u njoftohen nga DAP-i, brenda muajit maj, njësive të burimeve njerëzore të këtyre institucioneve, të cilat njoftojnë nëpunësit përkatës. Njësitë përgjegjëse për institucionet e pavarura, pas përcaktimit të listave të nëpunësve sipas pikës 10, të kreut II, të këtij vendimi, njoftojnë këta nëpunës brenda muajit maj.”.

3. Në kreun III bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

a) Pikat 2 dhe 3 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2. Testimi paraprak duhet të përfshijë të gjitha ndryshimet dhe të rejat që i përkasin fushës përkatëse, sipas grupimit, të cilit i përket nëpunësi civil, dhe të përcaktuara sipas pikës 7, të kreut II, të këtij vendimi.

3. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, dhe njësitë përgjegjëse, për institucionet e pavarura, në bashkëpunim me ASPA-n, përcaktojnë datën e testimit paraprak për çdo grupim dhe njoftojnë njësitë e burimeve njerëzore të institucioneve, të paktën, një muaj përpara datës së zhvillimit të testimit.”.

b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Testimi paraprak i nëpunësve civilë realizohet nga komisioni i vlerësimit (KV), me përbërje, si më poshtë vijon:

a) Për institucionet e administratës shtetërore:



- një përfaqësues nga DAP-i, i cili kryeson komisionin;

- një përfaqësues nga ASPA;

- një anëtar nga TND-ja, që zgjidhet nga DAP-i.

Në rastin e testimit të nëpunësve civilë të njësive teknike të përmbajtjes së sistemeve tatimore e doganore, përfaqësuesi i TND-së do të zgjidhet nga anëtarët e TND-së të ministrisë përgjegjëse për këto sisteme;

- dy ekspertë të fushës.

b) Për institucionet e pavarura:

- një përfaqësues nga njësia përgjegjëse e institucionit të pavarur, që po zhvillon procedurën, i përzgjedhur nga drejtuesi i njësisë përgjegjëse, i cili kryeson komisionin;

- një përfaqësues nga ASPA;

- nëpunësi më i lartë civil i institucionit të pavarur, që po zhvillon procedurën;

- dy ekspertë të fushës.”

c) Pikat 11 e 12 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“11. Në rast se anëtarët e KV-së, përfaqësues të DAP-it, ASPA-s, njësive përgjegjëse të institucioneve të pavarura, TND-së apo nëpunësi më i lartë civil i institucionit të pavarur janë në kushtet e pamundësisë ligjore për të qenë anëtarë të KV-së ose, në mënyrë të pajustificuar, nuk marrin pjesë në KV, ata zëvendësohen me nëpunës të tjerë të të njëjtit institucion, nga organet e emërtesës.

12. Vlerësimi i nëpunësve civilë, të cilët i nënshtrohen procedurës, bëhet nëpërmjet testimit me shkrim. Vlerësimi maksimal është 100 pikë.”

d) Në pikën 13, fjalët “... dhe për intervistën me gojë...” hiqen.

dh) Pas pikës 15 shtohet pika 15/1, me këtë përmbajtje:

“15/1. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, dhe njësitë përgjegjëse, për secilin institucion të pavarur, detyrohen të krijojnë listat e nëpunësve civilë që i janë nënshtuar procedurës së testimit paraprak, së bashku me vlerësimet përkatëse.”

e) Në pikën 20, pas fjalëve “... rekomandimet e DAP-it ...”, shtohen fjalët “... për institucionet e administratës shtetërore dhe të njësive përgjegjëse të institucioneve të pavarura, për këto institucione.”

ë) Pas pikës 22 shtohen pikat 23 dhe 24, me këtë përmbajtje:

“23. Brenda 10 ditëve, nga përfundimi i testimit me shkrim, Departamenti i Administratës Publike,

për institucionet e administratës shtetërore, dhe njësitë përgjegjëse, për institucionet e pavarura, u njoftojnë nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtuar procedurës, si dhe njësive të burimeve njerëzore të institucioneve, ku këta nëpunës civilë janë të punësuar, rezultatit e testimit me shkrim.

24. Brenda afatit të përcaktuar në pikën 23, të kreut III, të këtij vendimi, Departamenti i Administratës Publike, për institucionet e administratës shtetërore, dhe njësitë përgjegjëse, për institucionet e pavarura, i vënë në dispozicion ASPA-s të dhënat për nëpunësit e vlerësuar “kënaqshëm” dhe “jokënaqshëm”.”

f) Kudo në kreun III, shkurtimi “KVP”, zëvendësohet me “KV”.

4. Në kreun IV bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, fjalët “... nga eprori direkt...” hiqen;

b) Në fund të pikës 1 shtohet fjalia, me këtë përmbajtje:

“Periudha 3-mujore e vlerësimit fillon 10 ditë pas përfundimit të testimit paraprak.”

c) Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Brenda 5 ditëve, nga përfundimi i afatit të përcaktuar në pikën 23, të kreut III, të këtij vendimi, ASPA njofton nëpunësit e vlerësuar “jokënaqshëm” për kalendarin e zhvillimit të trajnimit, duke u vënë në dispozicion programet e trajnimit dhe materialet përkatëse. Në çdo rast, këto trajnime zhvillohen brenda gjysmës së parë të periudhës 3-mujore të vlerësimit.”

ç) Pikat 4, 5 dhe 6 shfuqizohen.

d) Fjalia e dytë e pikës 8 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Mosrespektimi i kësaj dispozite pa shkaqe të arsyeshme konsiderohet shkelje e detyrimeve të përcaktuara në ligjin për nëpunësin civil dhe përbën shkak për fillimin e ecurisë disiplinore.”

dh) Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Në rast të mosrespektimit të detyrimit të përcaktuar në pikën 8, të kreut IV, të këtij vendimi, për një nga shkaqet e arsyeshme sipas pikës 5, të kreut II, të këtij vendimi, nëpunësi civil është i detyruar të ndjekë nga fillimi trajnimit përkatës, brenda 3 muajve, nga data e rikthimit në punë.”

e) Pikat 11, 12 e 13 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“11. Testimi i nëpunësve civilë, të cilët kanë përfunduar trajnimin, realizohet nga i njëjti



komision vlerësimi (KV) që ka zhvilluar procedurën e testimit paraprak.

12. Procedurat e rregullat për zëvendësimin e ekspertëve në KV dhe për pagesën e tyre, si dhe për zëvendësimin e anëtarëve të tjerë të KV-së janë të njëjta me ato të përcaktuara në pikat 9, 10 e 11, të kreut III, të këtij vendimi.

13. Vlerësimi i nëpunësve civilë, të cilët i nënshtrohen procedurës, bëhet nëpërmjet testimit me shkrim. Vlerësimi maksimal është 100 pikë.”

ë) Në pikën 14, fjalët “... dhe për intervistën me gojë ...” hiqen.

f) Pas pikës 16 shtohen pikat 16/1 dhe 16/2, me këtë përmbajtje:

“16/1. Brenda 10 ditëve, nga përfundimi i testimit me shkrim, ASPA u njofton rezultatin nëpunësve civilë, të cilët u janë nënshtuar procedurave të trajnimit e testimit, Departamentit të Administratës Publike, njërive përgjegjëse të institucioneve të pavarura dhe njërive të burimeve njerëzore të institucioneve ku nëpunësit civilë janë të punësuar.

16/2. DAP-i, për institucionet e administratës shtetërore, dhe njësitë përgjegjëse, për secilin institucion të pavarur, detyrohen të krijojnë listat e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtuar testimit, në përfundim të trajnimit, së bashku me vlerësimet përkatëse.”

g) Në pikën 19, pas fjalëve “... rekomandimet e DAP-it ...” shtohen fjalët “... për institucionet e administratës shtetërore dhe të njërive përgjegjëse të institucioneve të pavarura, për këto institucione ...”.

gj) Pika 22 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“22. Në përfundim të procedurave të mësipërme, nëpunësi civil vlerësohet jo i përshtatshëm me vendin e punës në rastin kur si rezultati në përfundim të periudhës së vlerësimit 3-mujor edhe rezultati i testimit me shkrim, në përfundim të trajnimit, janë “jokënaqshëm”.

II. Përfundimisht për vitin 2018, përcaktimi i fushave, sipas pikës 7, të kreut II, të këtij vendimi, të bëhet brenda muajit qershor 2018.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 126, datë 7.3.2018

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 475, DATË 8.6.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PJESËMARRJEN E NJË TOGE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË NATO-S NË LETONI”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurave të vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të shkronjës “ç”, të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, “Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 475, datë 8.6.2017, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në pikën 1, numri “...18 (tetëmbëdhjetë)...” ndryshohet dhe bëhet “...21 (njëzet e një)...”.

b) Pika 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“5. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2019, me sistem rotacioni. Periudha e rotacionit, për çdo togë, të jetë 6 (gjashtë) muaj, së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me togën e radhës.”.

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

**VENDIM****Nr. 137, datë 28.2.2018****PËR NGRITJEN E TASK-FORCËS
PËR EVIDENTIMIN E PASURIVE
TË PALUAJTSHME SHTETËRORE
GJATË BREGDETIT SHQIPTAR,
ME QËLLIM INVESTIMIN
NË TURIZMIN BREGDETAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, dhe të ligjit nr. 93/2015, “Për turizmin”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Task-Forcës, në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, për evidentimin e pronave të paluajtshme shtetërore gjatë bregdetit shqiptar, krijimin e një regjistri me bazën e të dhënave të këtyre pasurive, si dhe për dhënien e rekomandimeve përkatëse Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për kryerjen e investimeve në turizmin bregdetar, në këto pasuri të paluajtshme.

2. Struktura e Task-Forcës miratohet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit. Personeli i Task-Forcës caktohet nga ministri i Turizmit dhe Mjedisit.

3. Task-Forca evidenton dhe regjistron në një regjistër të veçantë pasuritë e paluajtshme shtetërore, që ndodhen 1,5 (një presje pesë) kilometra nga vija bregdetare e Republikës së Shqipërisë dhe që mund të përdoren për investime në turizmin bregdetar, me të gjitha të dhënat e tyre.

4. Task-Forca trajton të gjitha pasuritë e paluajtshme shtetërore (objekt, truall, tokë bujqësore, pyll, livadh, kullotë etj.) në pronësi apo përgjegjësi administrimi të institucioneve qendrore ose të njëjësive të vetëqeverisjes vendore, të cilat shtrihen deri në 1,5 (një presje pesë) kilometra në thellësi të territorit tokësor të Republikës së Shqipërisë, nga vija bregdetare e Republikës së Shqipërisë.

5. Për realizimin e punës, Task-Forca kryen këto detyra:

a) Evidenton pasuritë e paluajtshme shtetërore që ndodhen 1,5 (një presje pesë) kilometra nga vija bregdetare e Republikës së Shqipërisë;

b) Krijon dhe administron regjistrin me bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme shtetërore përgjatë bregdetit shqiptar, së bashku me dosjen e plotë të dokumentacionit shoqërues të këtyre pasurive;

c) Bashkëpunon me investitorët e interesuar, me ministrinë e linjës apo institucionet e qeverisjes qendrore dhe vendore;

ç) Trajton dhe analizon vlerësimet e organeve të qeverisjes qendrore e vendore, të cilat administrojnë pasuri të paluajtshme shtetërore, me qëllim investimin në turizmin bregdetar;

d) Shqyrton dokumentacionin e dosjeve të pasurive të paluajtshme dhe kryen verifikimet e nevojshme;

dh) Administron dosjet me dokumentacionin shoqërues të çdo pasurie të paluajtshme shtetërore, e cila mund të përdoret për turizëm bregdetar, dhe, në rast se konstaton mangësi dokumentacioni për një pasuri të caktuar, merr masa për t'i plotësuar këto mangësi.

6. Task-Forca konsultohet dhe u kërkon mendim paraprak organeve të qeverisjes qendrore e vendore, të cilat kanë në përgjegjësi administrimi apo në pronësi pronat e paluajtshme shtetërore të evidentuara për t'u përdorur për investime në turizmin bregdetar. Për këtë qëllim, Task-Forca u kërkon organeve të qeverisjes qendrore e vendore të japin informacion në lidhje me pasuritë e paluajtshme të propozuara, përdorimin aktual ose të planifikuar të tyre, si dhe të shprehin mendimin e tyre vlerësues në lidhje me përfshirjen e këtyre pasurive në investim për turizëm bregdetar.

7. Në çdo rast, organet e qeverisjes qendrore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, që administrojnë pasuritë e paluajtshme shtetërore të propozuara për t'u përfshirë në turizëm bregdetar, i përcjellin Task-Forcës, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës, dosjen e plotë, në të cilën përfshihet i gjithë dokumentacioni i pasurive të paluajtshme, i vërtetuar nga zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

8. Task-Forca shqyrton dokumentacionin e dosjes së pasurive të paluajtshme dhe verifikon nëse këto pasuri janë objekt i:



a) procedurave administrative të njohjes, kthimit ose kompensimit të pronës apo objekt i pretendimeve të pronësisë nga palë të treta;

b) një procesi gjyqësor për titullin e pronësisë;

c) procedurave administrative të legalizimit;

ç) procedurave të marrjes së tokës në pronësi/në përdorim.

9. Task-Forca përfshin në regjistrë edhe pasuritë e paluajtshme, të cilat, sipas dokumentacionit, janë pasuri shtetërore, por që janë në konflikte gjyqësore apo në konflikte administrative me palë të treta, në lidhje me titullin e pronësisë.

10. Nëse Task-Forca vëren parregullsi në dokumentacion apo shkelje ligjore dhe shkelje të procedurave lidhur me pasuritë e paluajtshme, ajo informon ministrin e Turizmit dhe Mjedisit, i cili ia dërgon çështjen institucioneve përkatëse për marrjen e masave të duhura.

11. Task-Forca u kërkon informacion organeve shtetërore përkatëse, përfshirë, por pa u kufizuar në Agjencinë e Trajtimit të Pronës, Agjencinë e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritetit të Zonave/Ndërtimeve Informale, zyrtarët e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe prefekturat. Këto institucione detyrohen të japin informacion të qartë për pasurinë e paluajtshme brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga data e marrjes së kërkesës.

12. Task-Forca do të funksionojë dhe do të realizojë detyrat e përcaktuara në këtë vendim deri në datën 31 korrik 2019.

13. Task-Forca do ta ushtrojë aktivitetin në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit, ku do të pajisjet me zyra e mjete pune.

14. Task-Forca, brenda afatit të përcaktuar në pikën 12, të këtij vendimi, u paraqet ministrave të Turizmit dhe Mjedisit dhe të Financave dhe Ekonomisë raportin e plotë të punës së kryer, regjistrin e pronave të paluajtshme shtetërore, si dhe rekomandimet përkatëse për kryerjen e investimeve në turizmin bregdetar në këto pasuri të paluajtshme.

15. Task-Forca bashkëpunon me të gjitha institucionet shtetërore, përfshirë ministrinë e linjës dhe institucionet e tyre të varësisë, si dhe me agjenci, ente, persona juridikë, publikë, organe të qeverisjes qendrore apo njësi të vetëqeverisjes vendore, për realizimin e detyrave.

16. Anëtarët e Task-Forcës merren në punë me afat të caktuar, i cili i korrespondon afatit të

përcaktuar në pikën 12 (dhe ndryshimit që ky afat mund të ketë në të ardhmen). Për punën e kryer, anëtarët e jashtëm të Task-Forcës përfitojnë një pagë mujore, në masën e përcaktuar sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si dhe dieta e shpenzime të nevojshme për realizimin e objektit të veprimtarisë.

17. Administrimi dhe përditësimi i të dhënave të regjistrit me bazën e të dhënave të pasurive të paluajtshme gjatë bregdetit shqiptar bëhen nga Task-Forca. Krijimi dhe administrimi teknik i sistemit informatik të regjistrit bëhet nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, në përputhje me shkronjën “y”, të pikës 6, të vendimit nr. 673, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për riorganizimin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit”.

18. Ministri përgjegjës për turizmin miraton rregulloren për mënyrën e protokollimit të dokumentacionit dhe të korrespondencës së Task-Forcës.

19. Efektet financiare për ushtrimin e veprimtarisë së Task-Forcës, përfshirë shpenzimet për krijimin e regjistrit, të përballohen nga buxheti i Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit për vitin 2018, si dhe nga burime financiare e materiale, të siguruar për këtë qëllim në mënyra të ligjshme nga institucione vendëse ose të huaja.

20. Kryetari i Task-Forcës u raporton Kryeministrit, ministrin të Turizmit dhe Mjedisit dhe ministrin të Financave dhe Ekonomisë sa herë çmohet e nevojshme për veprimtarinë e këtij grupi, përfshirë edhe për nevojat e përdorimit të fondeve të caktuara për këtë qëllim.

21. Ngarkohen ministri i Turizmit dhe Mjedisit, ministri i Financave dhe Ekonomisë, Task-Forca e ngritur me këtë vendim dhe të gjitha institucionet shtetërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama



ANEKS I

1. Pagesa e kryetarit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-a.
2. Pagesa e anëtarëve të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë II-b.
3. Pagesa e ndihmësit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të kategorisë III-a.
4. Pagesa e sekretarit/sekretares (sekretariati) përcaktohet në masën 30 000 lekë/muaj.
5. Shpenzimet për dieta, fjetje dhe transport për Task-Forcën, sipas vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, të ndryshuar.
6. Shërbimet autorizohen dhe mbikëqyren nga kryetari i Task-Forcës.

*Shënim: Për pikat 1, 2, 3 referohet Lidhja 1 e vendimit nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, të Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit”, të ndryshuar.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2018

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 84 lekë